BASHKIA SELENICE

Boro,

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA SELENICË
KËSHILLI

Nr. 3011 Prot.

Selenicë, më 31 / 12 / 2025

VENDIM

Nr 78 datë 29/12/2025

PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË BUXHETIT AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIN E VITIT 2026 , KALENDARIN ORIENTUES PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE VENDORE PBA 2027-2029 DHE BUXHETIN E VITIT 2027 ,

Në zbatim të nenit 8 pika 2,nenit 9 pika 1,nënpikat 1.1 shkronja "b",1.3 shkronja "c",nenit 41 pika 1,neni 54 shkronja "c",të ligjit Nr **139/2015** "Per Vetëqeverisjen vendore",ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise",te ndryshuar,kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29,kreu VII nenet 39-41 të ligjit Nr 68/2017 datë 27.04.2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore",i ndryshuar,të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr 87/2025"Per Buxhetin e Vitit 2026",nenin 9 të ligjit nr.35/2023 "Për kopentencat për caktimin e pagave ,trajtimeve të tjera financiare ",të ndryshuar,V.K.MNr 328,dt 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civil e të punonjësve administrativ :ndryshuar me V.K.M nr 530,dt 01.08.2024 ,V.K.M nr 419,dt 26.06.2024 "Për pagat e punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ,V.K.M nr 425 ,dt 26.06.2024 "Për nivelin e pagave të punonjesve mësimor dhe të punonjësve të tjerë joarsimor në institucionet arsimimore .V.K.M nr 422,dt 26.06.2024 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike ,Vendimin Nr 776 ,datë 19.12.2025"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018"Për proçedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetqeverisjes vendore",udhëzimit nr.8 datë 28.02.2025 i Ministrit të Financave "Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor 2026-2028 ",si dhe udhëzimit plotësues Nr 19,të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028" i datës 10.07.2025,si dhe shkresa e Ministrisë së Financave ,Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit,Drejtoria e Financave Vendore me nr15867Prot datë 06.11.2025(transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026)

VENDOSI

1. Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028
2. Miratimin e tabelës së të ardhurave për vitin 2026
3. Miratimin e tabelës së shpenzimeve totale për vitin 2026
4. Miratimin e tabelës së shpenzimeve operative (*llog ek 602*) viti 2026
5. Miratimin e tabelës së shpenzimeve kapitale (*llog ek 230/231*) viti 2026
6. Miratimin e tabelës së detyrimeve të prapambetura *(llog ek 602/230/231)*viti 2026
7. Miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore PBA 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027
8. Për zbatimin e këtij **Vendimi** ngarkohet Bashkia Selenicë
9. Ky Vendim hyn në fuqi mbas shprehjes së ligjshmërisë

KRYETARI
Nimet Dapaj

BASHKIA SELENICË - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SELENICË

SHTOJCA 2

Struktura e Dokumentit Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026

FAZA E TRETË

DHJETOR
2025

Përmbajtja

HYRJE **4**

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR 4

1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË 6

2.VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË SELENICË **8**

Popullsia: *9*

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE 10

Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë *10*

2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË SELENICË 11

Proritetet e Bashkisë Selenicë. *11*

2.3 INFORMACIONI FINANCIAR KRYESOR 11

3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË **11**

3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË/STRATEGJIA PERSONELI 12

3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT 12

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË SELENICË **13**

4.1 TË ARDHURAT E PARASHIKUARA TË BASHKISË SELENICË PËR VITET 2026-2028 13

4.2 TË ARDHURAT E VETA TË BASHKISË SELENICË 16

4.3 TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE 16

4.4 NUMRI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE 16

4.5 NUMRI I TAKSAPAGUESEVE FAMILJARE 17

4.6 TAKSAPAGUESIT TE BIZNESIT 17

4.7 NUMRI I BIZNESEVE SIPAS KATEGORISË 17

4.8 GRUPIMI I BIZNESIT SIPAS NATYRËS 17

4.9 TË ARDHURAT 20

4.10 PLANI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË SELENICË PËR PERIUDHËN 2026-2028 20

PBA3 - SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK 20

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE **22**

5.1 P.B.A 6 QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT 22

5.2 PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT 36

5.3 PROJEKTET E INVESTIMEVE TE PROGRAMIT 46

01110 PLANIFIKIMI, ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI 48

04240 MENAXHIMI I UJITJES DHE KULLIMIT 49

04260 MENAXHIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE 49

04520 RRJETI RRUGOR RURAL 50

04940 FOND KONTIGJENCE 50

06260 SHERBIMET PUBLIKE VENDORE 51

06370 FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIME 51

08130 SPORT DHE ARGËTIM 51

09120 ARSIMI BAZË PËRFSHIRË SISTEMIN E ARSIMIT PARASHKOLLOR 52

09230 ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM 52

6 . INFORMACION BAZË MBI BASHKINË SELENICË **53**

BUXHETI I VITIT 2026 ..... **54**

7. SHPENZIMET E NJVQV SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (NIVELI I, II, III I COFOG) **61**

8. SHPENZIMET TOTALE TË BASHKISË SIPAS PROGRAMIT TË KATEGORIVE EKONOMIKE.....63
RISQET E IDENTIFIKUARA SIPAS SISTEMEVE.....66
PLANET E MENAXHIMIT TË RISQEVE QË NDIKOJNË NË PBA 2026-2028.....66

HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.
Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale

dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike;
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit,* synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë

hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit,* synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART[1]) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV- së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore

[1] Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

- Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Me marrjen e Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr.8 date 28.02.2025 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028",dhe miratimit te tavaneve te shpenzimeve te buxhetit afatmesem 2026-2028 nga Keshilli i NJQV-se, Kryetari i njesise se veteqeverisjes vendore ka nxjerre urdherin "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Aftmesem 2026-2028 dhe Buxhetit te vitit 2026,Faza I", drejtuar EMP (Ekipeve te Menaxhimit te Programeve) dhe Njesive Shpenzuese te Bashkise Selenice.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Me marrjen e Udhëzimit plotësues të Ministrusë së Financave "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028,dhe miratimit të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2026-2028nga Këshilli i Bashkisë si dhe në bazë të shkresës së Ministrisë së Financave,Drejtoria e Përgjithshmë e Buxhetit,Drejtoria e Financave Vendore Nr 9739 Prot ,datë 18.06.2025 protokolluar me tonën Nr 1460Prot datë 23.06.2025"Mbi komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028" ekipet e Menaxhimit të Programeve

buxhetore EMP-të kanë bërë rishikimin e DPP dhe PSHP brenda tavanit të fazës së dytë.

Procedura e vazhdimit të fazës së dytë për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor është realizuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të ligjit nr.68 datë 27.04.2017"Për financat e vetqeverisjes vendore ", të ndryshuar .

Pasi eshte bere miratimi i të gjitha formateve të PBA-së në Fazën e dytë, Dokumenti i PBA-së së Fazës së parë (Dokumenti i PBA-së) është aprovuar nga Koordinatori i GMS i paraqitet GMS-së për miratimin përfundimtar.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit .

2.Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Selenicë

Bashkia Selenicë është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Bashkia Selenicë kufizohet në veri me Bashkitë Fier dhe Mallakastër, në perëndim me Bashkinë Vlorë, në Jug me Bashkinë Himarë si dhe në Lindje me Bashkitë Himarë dhe Memaliaj. Qëndra e saj

administrative është qyteti i Selenicës, ku gjenden edhe institucionet kryesore. Pjesa më e madhe e territorit të kësaj Bashkie shtrihet midis dy korridoreve të rëndësishme ujore të Shqipërisë jug-përëndimore, dhe konkretisht midis lumit Vjosë dhe Shushicës, ose siç njihet ndryshe Lumi i Vlorës. Të dy këto korridore lumore krijojne kufij të dukshëm natyrorë, të cilët e konturojnë qartë masivin kodrinor malor të Bashkisë Selenicë. Ky masiv përkon me kufijtë veriorë fundorë të vargmalit të Gribës, ku kuotat gjeografike kulmojnë me majat e Kudhësit 1907m, Tartarit 1971m si dhe maja e Çipinit të Madh 1599m. Terreni i thepisur malor i lë vendin kodrave të ulëta në veri dhe veripërendim, për të zbritur më pas në luginën e Vjoses, deri në pikën e bashkimit të saj me lumin Shushica pranë fshatit Armen që përbën edhe pikën kulmore veriore të territorit të Bashkisë Selenicë. Ndërkohë, kufiri përëndimor i Bashkisë Selenicë konturohet nga kurrizi malor i Lungarës që fillon me majat e Qyramangës (1864m) dhe Çekut (1830) në Jug-përëndim, për të vazhduar drejt Veriut me majat e Sqillovikut (1486m), Vejave (1182m). Lidhja me Vlorën është e drejtpërdrejtë, ndërkohë që aksesi me Fierin mundësohet indirekt nëpërmjet Vlorës, dhe konkretisht nëpërmjet supërstradës Vlorë-Levan. Lidhja me bashkitë lindore dhe jugore është relativisht e kufizuar, e shkaktuar kjo në pjesën më të madhe nga morfologjia e terrenit si dhe nga mungesa e akseve të komunikimit. Lumi Vjosë funksionon si një kufi natyral i Bashkisë Selenicë me territoret në lindje të saj. Edhe pse pranë Bashkisë Selenicë kalon rruga Levan-Tepelenë që është një nga akset më të rëndësishme kombëtare të Jugut, lidhja me këtë aks mundësohet vetëm në një pikë, dhe konkretisht mbi urën e Poçemit. Rruga që mundëson këtë lidhje është një rrugë me karaktër rural. Për këtë arsye, skema komunikim-transport-shkëmbim të Bashkisë Selenicë është e orientuar totalisht drejt qytetit dhe periferisë lindore të Vlorës. Bashkia Selenicë është e pozicionuar pranë nyjeve të rëndësishme ekonomike kombëtare të Rajonit Jug-përëndimor të Shqipërisë, që janë Vlora dhe Fieri. Kjo afërsi gjeografike ofron mundësinë që potencialet e kësaj Bashkie në sektorë të ndryshëm si energjitika, bujqësia, turizmi, disa industri nxjerrëse dhe përpunuese të jenë komplementarë me asetët social ekonomike të qëndrave të sipërpërmendura, t`i lënë mundësi ekosistemit që t`u ofrojë shërbime në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontribuojnë në fuqizimin e dijes dhe inovacionit si motor i së ardhmes.
Bashkia e Selenicës shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë , i cili është degë e lumit Vjosë . Bashkia ka në territorin e saj minierën historike të bitumit në Selenicë , ku punësohen edhe banorët e fshatrave përreth , si dhe zonën naftëmbajtëse të Vllahinës.

Popullsia:
Sipas Censusit , zona e Bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorë ndërsa në regjistrin civil rezulton me 33.800 banorë . Dallimi i madh mes shifrave të regjistrit civil dhe të censusit flet për një shkallë të lartë emigrimi.Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 561.24 km^2.sipas të dhënave të censusit , Bashkia e re ka një densitet prej 32.9 banorësh për km^2ndërsa sipas regjistrit civil . densiteti është 60.22 banorë për km^2.
Kjo Bashki përbëhet nga 5 njësi administrative , të cilat janë : Armen , Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe Qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra
Bashkia e re përbëhet nga disa komuna të cilat lidhen me Qytetin e Selenicës fal ndërtimit të rrugës së re Peshkëpi Selenicë nga Fondi Zhvillimit Shqiptar .
Me ndërtimin e rrugës së re Vlorë Himarë Selenicë u hap perspektivë e re zhvillimi në saj të politikës së shtetit për ivestimet afatgjata strategjike
Bujqësia dhe blegtoria është aktiviteti kryesor ekonomik iBashkisë së re , popullsia e së cilës bazohet vecanërisht shumë te remitancat nga emigracioni për të siguruar të ardhurat e saj .

Si zone bujqësore ,Bashkia e Selenicës, është lidhur ngushtë me Bashkinë e Vlorës si treg i rëndësishëm për produktet e saj
Zhvillimi I infrastrukturës ndërlidhëse të Njësive Administrative pjesë përbërëse të Bashkise Selenicës , si dhe zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë identifikohen si sfidat kryesore të Bashkisë.
Politikat kombëtare financiare garantojnë funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e burimeve qe perbehen nga : Granti I pakushtezuar ,Grantit te kushtezuar ose konkurues dhe funksioneve te deleguara .Çdo njësi e qeverisjes vendore miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet te barazuar te ardhura- shpenzime.

Bashkia krijon të ardhura nga taksat dhe tatimet vendore mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, taksat dhe tatimet vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël, si dhe nga tarifat vendore për shërbimet publike që ato ofrojnë, për të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore, për dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve, etj. Bashkia vendos vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare. Bashkia mund të marr hua për qëllime publike vendore me miratim të Ministrisë Financave

Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet së bashku me pagesat e huasë.Transfertat e kushtëzuara, të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë.Çdo njësi e qeverisjes vendore ka autoritet të plotë për qëllimet dhe mënyrat e përdorimit të fondeve buxhetore të saj, që nuk janë transferta të kushtëzuara.Kur këto fonde nuk shpenzohen tërësisht gjatë vitit financiar në vazhdim, mbarten në buxhetin e vitit financiar pasardhës. Buxheti i njësive të qeverisjes vendore synon përdorimin me efektivitet të burimeve për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave paraqitjen qartë të situatës financiare

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Hartimi i objektivave mundëson realizimin e një plani që garanton një zhvillim të qëndrueshëm. Ecuria e procesit paralelisht me etapat e hartimit të Planit siguron një bashkëpunim frytëdhnës midis këtyre instrumentave në drejtim të ruajtjes së parametrave mjedisorë të zonës në studim si dhe atyre të shëndetit publik. Këto objektiva janë hartuar në përputhje me ligjshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbajtur parasysh direktivat evropiane, konventat ndërkombëtare dhe dokumenta të tjera të rëndësishëm. Ligjet shqiptare dhe direktivat e ndryshme evropiane lidhur nga njëra anë me tokën, biodiversitetin, pyjet, ujin e pijshëm, lumenjtë, rezervuarët dhe nga ana tjetër ato për shëndetin publik kanë shërbyer si orientuese në hartimin e këtyre objektivave.

Ndër objektivat më të rëndësishëm mund të përmendim:

Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë popullatën; Mbrojtja e të gjithë burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me qëllimin për ta bërë më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE.

Zhvillim urban të qëndrueshëm dhe planifikim i përdorimit të tokës.

Sigurimin e një zhvillimi te qëndrueshëm ekonomik me përqëndrim në agro-turizëm, bujqesi dhe mbështetje të ekonomisë rurale.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Selenicë

Proritetet e Bashkisë Selenicë

Krijimi i një mjedisi miqësor me natyrën duke bërë pastrim higjenizim nëpërmjet ndërtimit rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza e të bardha në gjithë njësitë e bashkisë Selenicë, Armen,Brataj,Kotë,Vllahin dhe Sevaster
Pastrim gjelbërim në të gjithë territorin duke qënë se jemi në buzë të lumit të Vjosës dhe Vjosa ka statusin e zonës së mbrojtur.
Ndërtimi i rrugëve të brendshme.

2.3 Informacioni financiar kryesor

Gjatë punës për përgatitjen e Projektbuxhetit Afatëmesëm, kujdes I veçantë I është treguar Vlerësimit të burimeve për 3 vitet e ardhshme. Janë marrë në konsideratë faktorët makro, si rritja reale ekonomike, norma e inflacionit si dhe parashikime nga institucione qëndrore si Banka e Shqipërisë, INSTAT por edhe burime informacioni nga agjentë të tjerë. Parashikimi është I përafërt me realitetin duke bërë të mundur që mosrealizimi i shpenzimeve të jetë në nivele sa më të ulëta.
Gjithashtu janë rritur lehtësisht shpenzimet për mirëmbajtjen e shkollave për të krijuar ambjente sa më të përshtatshme për fëmijet. Shpenzimet në buxhet janë planifikuar në bazë programi.

3. Orientimi afatgjatë i bashkisë

Bashkia do të jetë aktor kryesor në mbështetjen e zhvillimit ekonomik te zones me kompetenca dhe instrumente konkrete që nxisin sipërmarrjen dhe investimet. Klima lokale e biznesit do të mbështetet me nisma konkrete dhe investime publike që lehtësojnë thithjen e investimeve nga

biznesi. Promovimi dhe nxitja e klimës së biznesit do të jetë synim i veçante i Bashkisë Selenicë. Planifikimi i territorit do të vazhdojë të jetë një funksion i Bashkise. Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit, bashkia do të hartojë dhe miratojë planet territoriale. Ligji i ri për planifikimin e territorit i jep kompetencë bashkise për hartimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit. Në zbatim të reformës territoriale do të rishikohet plani ekzistues të zhvillimit të territorit. Nga Qeveria qendrore do të sigurohet, mbështetje financiare për Bashkine për rishikimin e planeve vendore dhe bazën e të dhënave të krijuara për territorin.

3.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia personeli

Ky program konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe të menaxhimit të Bashkisë Selenicë. Ai siguron mbështetjen në burime financiare, materiale dhe njerëzore të Aparatit të Bashkisë për realizimin e detyrave dhe objektivave që u janë ngarkuar në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të zhvillimit.

Qëllimet dhe objektivat e politikës së këtij programi konsistojnë në:

Menaxhimin sa më efektiv të burimeve njërëzore, rritjen e aftësive funksionale në të gjitha nivelet.

Ofrimi i shërbimeve të plota, cilësore dhe në një kohë të shkurtër për bisnesin dhe qytetarët.

Nxitja e qytetarëve, bisnesit dhe palëve të interesuara për t'u bërë pjesë e planifikimit të buxhetit.

Krijimin e një administrate profesionale, të aftë të përballojë sfidat gjithpërfshirëse të integrimit.

Përmirësimin e menaxhimit dhe përdorimit me eficencë të fondeve.

Administrim me eficencë dhe efektivitet të sistemit tatimor.

Transparencë, informim dhe asistencë ligjore për të gjithë tatimpaguesit.

Nxitja e qytetarëve, bisnesit dhe palëve të interesuara për tu bërë pjesë e planifikimit të buxhetit.

3.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Analiza e gjendjes ekzistuese së situatës gjatë studimit ka trajtuar këto çështje kyçe dhe problematika qe duhet të adresohen:

1. Problemet socio-ekonomike si rezultat lëvizjeve demografike
2. Aktivitetet e paqëndrueshme ekonomike dhe cilësia e ulët e produktit turistik.
3. Zhvillim informal.
4. Zhvillimi sporadik dhe i shpërndarë që çon në përdorim të paqëndrueshëm të tokës dhe urbanizimit.
5. Cilësia e dobët e ndërtimeve ekzistuese dhe të objekteve të turizmit.
6. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore e cila mbetet e pambrojtur.
7. Degradimi i peizazhit.
8. Keqpërdorimi i resurseve natyrore dhe tokës.

9. Cilësia e burimeve ujore.
10. Sistem i papërshtatshëm i vendgroposjeve dhe largimit te mbeturinave të ngurta.
11. Gurorët
12. Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor të bizneseve, popullsisë dhe vizitorëve.

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË SELENICË

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Selenicë gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Në projekt buxhet paraqeten të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

4.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Selenicë për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	78,286	95,121	158,070	158,070	169,880	173,468	166,161
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	27,212	34,931	55,300	55,300	55,500	67,778	57,449
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	1,634	2,746	7,400	7,400	7,500	7,600	7,714
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	16,046	28,223	43,000	43,000	43,000	55,178	44,660
1.1.3	Taksa mbi truallin	3,169	3,396	4,900	4,900	5,000	5,000	5,075
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	6,363	565	0	0	0	0	0
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	6,095	7,994	7,600	7,600	7,600	7,700	7,815
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,095	7,994	7,600	7,600	7,600	7,700	7,815
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	97	324	140	140	140	140	142

1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	57	250	0	0	0	0	0
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	0	0	0	0	0	0	0
1.3.3	Taksa e tabelës	40	74	140	140	140	140	142
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	41,778	40,677	90,030	90,030	101,640	92,850	93,755
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	31,230	32,019	14,000	14,000	15,000	15,000	15,225
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	168	143	0	0	0	0	0
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	59	72	330	330	340	350	355
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	5,624	3,130	4,000	4,000	4,500	5,000	5,075
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	169	501	5,700	5,700	5,800	6,000	6,100
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	26	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	4,323	5,000	5,000	5,000	5,500	6,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000
1.4.11	Tarifa e parkimit	0	12	0	0	0	0	0
1.4.12	Tarifa të tjera	4,502	477	55,000	55,000	65,000	55,000	55,000
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	0	4,539	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	0	4,539	0	0	0	0	0
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	3,104	6,656	0	0	0	0	2,000
1.6.1	Kamatëvonesat	0	23	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoba, sekuestrime dhe zhvdëmtime	1,248	1,353	0	0	0	0	0
1.6.3	Të tjera	1,856	5,280	0	0	0	0	2,000
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDRON	559,051	646,351	385,920	388,524	415,729	425,786	437,136
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	239,351	250,026	278,053	278,053	296,669	306,726	318,077
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	236,376	228,818	240,271	240,271	251,466	261,523	272,874

2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	2,975	21,208	37,782	37,782	45,203	45,203	45,203
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	0	0	0	0	0	0
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	86,005	97,366	107,867	110,471	119,059	119,059	119,059
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	0	0	0	0	0	0	0
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	34,178	35,063	41,197	41,197	44,287	44,287	44,287
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	0	5,436	5,653	5,653	7,105	7,105	7,105
2.2.4	Arsimi parauniversitar	10,330	11,404	11,859	11,859	14,147	14,147	14,147
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	16,598	19,126	21,797	24,401	23,855	23,855	23,855
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	4,947	5,479	5,698	5,698	6,834	6,834	6,834
2.2.8	Rrugët	3,037	3,384	3,490	3,490	3,596	3,596	3,596
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	16,915	17,475	18,173	18,173	19,235	19,235	19,235
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	0	0	0	0	0
2.2.12	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2.3	TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA	233,695	298,958	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	168,104	298,958	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	65,591	0	0	0	0	0	0
2.4	TRANSFERTË SPECIFIKE	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transferte specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	16,630	22,073	19,000	19,000	20,000	20,000	20,000
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	5,402	6,778	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000
3.2	Renta minerare	3,705	6,903	6,000	6,000	7,000	7,000	7,000
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	7,523	8,393	7,000	7,000	7,000	7,000	7,000
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	0	23,828	0	5,209	0	0	0
4.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	0	17,619	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	17,619	0	0	0	0	0
4.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	0	0	0	0	0	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
4.3	GRANTE TË HUAJA	0	6,209	0	5,209	0	0	0
4.3.1	Grante të huaja	0	6,209	0	5,209	0	0	0

5	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
6	TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR	70,759	74,724	150,000	199,920	45,000	60,000	60,000
6.1	Trashëgimi pa destinacion	70,759	66,440	135,000	184,920	45,000	50,000	50,000
6.2	Trashëgimi me destinacion	0	8,284	15,000	15,000	0	10,000	10,000
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV	724,726	862,096	712,990	770,723	650,609	679,254	683,297

4.2 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Selenicë

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

4.3 Taksat dhe Tarifat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

4.4 NUMRI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE

Bashkia Selenicë ka gjithsej 9139familje taksapaguese, 294 biznese . Të dhënat janë marrë nga rregjistrat e Drejtorisë së Tatimeve pranë Bashkisë Selenicë. Më poshtë pasqyrohen numri i taksapaguesve sipas njësive administrative dhe rajoneve të Bashkisë Selenicë.

Nr.	Njësia Administrative	Familjet	Bizneset	Institucione
1	Selenicë	1538	61	
2	Armen	1534	54	
3	Brataj	1357	34	
4	Kotë	1502	73	
5	Sevaster	672	14	
6	Vllahinë	2536	58	
	Totali	**9139**	**294**	

4.5 NUMRI I TAKSAPAGUESEVE FAMILJARE

Ne evidentimin e kryer del se ka familje të cilat përfitojnë lehtësira fiskale në mbështetje të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" neni22, pika6 i ndryshuar i cili citon ndër te tjera se: *6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat: ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë; f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;*

4.6 TAKSAPAGUESIT TE BIZNESIT

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Tatim Taksave , numri i bizneseve që ushtrojne aktivitetin ne territorin e Bashkise Selenicë është 294.
Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas kategorisë dhe shpërndarjes administrative.

4.7 Numri i bizneseve sipas kategorisë

Nr.	Fusha e veprimtarisë	Njësi admistrative	Bashki	Totali
1	Biznes i madh	14	9	23
2	Biznes i vogël	196	42	238
3	Biznes Transporti	23	10	33
	Totali	**233**	**61**	**294**

4.8 GRUPIMI I BIZNESIT SIPAS NATYRËS

Në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 294 biznese Ky biznes është i shpërndarë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr	Fusha e veprimtarisë	Njësi admistrative	Bashki	Totali
1	Ndërtim		3	3
2	Prodhim	20	2	22
3	Profesion i lirë		5	5
4	Shërbim	90	1	91
5	Transport	23	10	33
6	Tregti	100	40	140
		233	**61**	**294**

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA- së.

Të ardhurat e Bashkisë Selenicë për vitet 2026-2028, që do të sigurohen nga transfertat specifike, janë financime të funksioneve të deleguara nga Ministria e Financave për arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, mbrojtjen nga zjarri, ujitjen e kullimin, administrimin e pyjeve dhe rrugët rurale.

- *Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor*. Në transfertën specifike janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor të ndarë për personelin mësimor ku perfshihet pagat e edukatoreve të kopshteve dhe gjithashtu perfshihen dhe pagat për stafin mbeshtetes te arsimit parashkollor si sanitarë, rojet e objekteve të shkollave .
- *Per arsimin parauniveristar.* Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar perfshihen pagat për sekretarët e shkollave të mesme, sanitarët dhe disa roje shkollash të mesme.
- *Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH*). Në transfertën specifike janë fondet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.
- *Rrugët rurale*. Në transfertën specifike, janë fondet për rrugët rurale
- *Administrimi i pyjeve*. Në transfertën specifike janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, si dhe shpenzimet operative. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transferta specifike. Vlen të theksohet fakti se ky fond është i pamjaftueshëm për kryerjen e këtij funksioni. Fondi është i pamjaftueshëm për pagat e punonjësve të Drejtorisë së Pyjeve. Kështu që Bashkia Selenicë ka qenë e detyruar të mbulojë edhe shpenzimet për paga edhe shpenzimet operative për kryerjen e këtij funksioni.
- *Ujitja dhe Kullimi*. Në transfertën specifike janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.
- *Mbrojtja Sociale*. Fondi i akorduar per kete funksion vjen nga transferta specifike

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Të ardhurat e Bashkisë Selenicë, që do të sigurohen nga Transferta e pakushtëzuar, i janë bërë

të ditura Bashkisë nga Ministria e Financave me shkresën 4074/1 datë 04.03.2025.

Gjithashtu mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e Buxhetit afatmesëm 2026-2028, i janë njoftuar Bashkisë Selenicë edhe fondet e transfertës së pakushtëzuar për vitet 2026- 2028.

Detajimi i fondeve për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme të planifikuar për vitin 2026,si dhe detajimin e fondeve për transfertën e pakushtëzuar sektoriale janë çelur në sistem si dhe janë protokolluar në institucion me shkresën Nr2624Datë datë 10.11.2025,në bazë të shkresës 2r 15867 datë 06.11.2025 të Ministrisë së Financave,Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit ,Drejtoria e Financave Vendore .

Në bazë të shkresës së Ministrisë së Financave Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e buxhetit të vitit 2026 dhe buxhetin afatmesëm 2026-2028 me Nr.150 datë 11.11.2025 protokolluar me shkresën Nr.2635 datë 11.11.2025.

Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura
Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas

një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjëse për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme

Kjo takse eshte 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë.

4.9 TË ARDHURAT

Të ardhurat në njësinë e pushtetit vendor perfshin:
- Të ardhura tatimore
- Të ardhura jotatimore ku përfshihen të ardhurat nga shitja ose dhënia me qira të pronave të kësaj bashkie, sponsorizimeve e gjobave.
-Trasferta e pakushtëzuar nga Qeverisja Qendrore – granti.
-Të ardhura nga aluizni në procesin e legalizimit sipas ligjit 9482dt 03.04.2006 "Për legalizimin dhe ndërtimeve pa leje "të ndryshuar". Procedura dhe menyra e përdorjes së këtyre të ardhurave janë saktësuar me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 37 datë 20.11.2008 "Për përdorimin e të ardhurave nga ndërtimet pa leje.
-Të ardhura nga trasferta me destinacion ose trasferta e kushtëzuar.
-Të ardhura nga trasferta specifike ose sektoriale.

4.10 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Selenicë për periudhën 2026-2028

PBA3 - SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	**181,115**	**211,594**	**277,369**	**288,963**	**312,213**	**314,438**	**314,578**
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	153,710	181,583	236,563	247,450	267,235	268,835	269,835
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	27,405	30,011	40,806	41,513	44,978	45,603	44,743
	Shpenzime Korrente te Tjera (602-609, 651, 1661)	**88,339**	**90,471**	**201,926**	**214,022**	**118,289**	**95,840**	**200,719**
602	Malira dhe sherbime te tjera	87,939	86,048	199,926	212,022	114,689	95,840	200,719
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	400	4,423	2,000	2,000	3,600	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0

651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
